

## Konkluzionet përfundimtare operative, grupi implementues për lirinë e lëvizjes

1. Konkluzionet operative të dialogut për lirinë e lëvizjes të datës 2 korrik 2011 janë zbatuar në tërësi më 29 nëntor 2011;
2. Qytetarët e Kosovës që udhëtojnë në ose nëpër Serbi do të pajisen me dokument hyrje/dalje;
3. Qytetarët e Serbisë që udhëtojnë në ose nëpër Kosovë do të pajisen me dokument hyrje/dalje;
4. Dokumenti përfundimtar hyrje/dalje i secilës palë është i bashkëngjitur me këto konkluzione;
5. Pas kërkesës për konfirmim të identitetit, LNJ tregohet bashkë me këtë dokument hyrje/dalje;
6. Dokumenti hyrje/dalje quhet dokument hyrje/dalje. Gjuha në dokument hyrje/dalje do të jetë vetëm gjuhë procedurale: “dokumenti hyrje/dalje nuk bën të humbet dhe në rast të humbjes, personi gjegjës duhet t’i drejtohet stacionit më të afërt të policisë për tu pajisur me vërtetim që ai/ajo ka humbur dokumentin hyrje/dalje etj”;
7. Dokumenti hyrje/dalje nuk do të përmbaj fotografi;
8. Të miturit që udhëtojnë me certifikatë lindjeje do të pajisen me dokument të veçantë hyrje/dalje dhe duhet të sjellin një fotografi me vete për të siguruar sistemin nga trafikimi i fëmijëve;
9. Në fillim do të jenë të hapura dy vendkalime, një mes Serbisë dhe Hungarisë (Horgosh) dhe një mes Serbisë dhe Kroacisë (Batrovci) për hyrje/dalje nga Serbia. Gradualisht, më vonë do të hapën të gjitha vendkalimet e tjera.
10. Në fillim do të hapen portat 1, 3 dhe 5. Gradualisht, më vonë do të hapën të gjitha vendkalimet e tjera.
11. Duke marrë parasysh konkluzionet për MIK, palët janë pajtuar që të shikojnë periudhën tranzicionale për zbatimin e pikës 7 për tabelat e regjistrimit në konkluzionet operative për lirinë e lëvizjes në dritën e situatës në terren;
12. Automjetet me tabela regjistrimi KS do të mund të udhëtojnë në/nëpër Serbi;
13. Secila palë do të vendosë skemë të sigurimit në kufi/në vijë administrative. Çmimi i sigurimit do të jetë në pajtim me çmimorën e sigurimit të aplikueshëm në kufi/në vijë, i cili aktualisht si kohë më të shkurtë parashihet periudhën njëmuajshe në palën e Beogradit. Pala e Beogradit do të bëjë çdo përpjekje për të vendosur polica më të lira sigurimi për periudha më të shkurta brenda javësh;
14. Njëkohësisht, palët, nën kujdesin e BE/Këshillit të Byrove, do të vazhdojnë të punojnë në gjetjen e aranzhimeve komerciale për mbulimin e ndërsjellë të sigurimit të automjeteve saqë të gjitha automjetet të jenë të mbuluara në dy anët e kufirit/të vijës administrative sa më shpejtë të jetë e mundur;
15. Tabelat e regjistrimit të automjeteve me RKS do të zëvendësohen me tabela të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve në palën e Serbisë. Sa më shpejtë të jetë e mundur operacionalisht, do të zbatohet një taksë e zbritur për tabela të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve. Pala e Kosovës do të zbatoj të njëjtën taksë;
16. Pala e Kosovës rezervon të drejtën që, pas konsultimeve me BE-në, gjithashtu të zbatojë regjimin e tabelave të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve;
17. Në fillim, do të përdoren tabela të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve ashtu siç janë;
18. Beogradi dhe Prishtina janë zotuar të punojnë për aplikimin e tabelave “neutrale” të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve sa më shpejtë që të jetë operacionalisht e realizueshme.